AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70917093-00156-2

3990/2023

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:

Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:

Komuna / Opština / Municipality:

Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:

Zyra kadastrale komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:

15.02.2023 - 09:39

KAÇANIK / KAČANIK / KAČANIK

Koxhaj / Koxhaj / Koxhaj

KAÇANIK / KAČANIK / KAČANIK

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësies kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësies Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
P-70917093-00156-2	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land		14974	11-2006		

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Azhuruar Azurirano Updated
MERAJA			

Zyrtari përgjegjës / Odgovorne lice / Official person

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcelle Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcelle Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja Površina Area
1	Bujqësori /Poljoprivredno/Agriculture	Kullosat/Pašnjaci/pasture	Kullosë E Klases 4/Pasnjak 4 Klase/4th Class Pasture	14974

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Liceni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	Komuna e Kaçanikut	600246913	/ / /		QAMIL ILAZI	1/1		13.12.2013






REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVA CADASTRAL AGENCY
KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office : KAÇANIK
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Koxhaj

3990/2023

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-70917093-00156-2	Parcelë / Parcela / Parcel	14974



Shkalla/Razmera/Scale: 1:1681

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 15.02.2023

Koha/ Vreme/ Time: 09:39:59

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

Aprovoi/Usvojio/Approved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature:



Dobësitë:

- Zonat urbane dhe qendrat sekondare ndiejnë nevojë për plane rregulluese,
- Ngadalësim i zhvillimit të qytetit nga se vjen në shprehje ndarja e mjeteve në mënyrë të barabartë.

1.2. Strukturat kryesore hapësinore

Planifikimi dhe menaxhimi i zhvillimeve të ardhshme hapësinore, ka për qëllim zhvillimin e balancuar ekonomik, social, të infrastrukturës, mbrojtjes dhe shfrytëzimit racional të resurseve. Aktualisht shpërndarja hapësinore e zhvillimeve në komunën e Kaçanikut ka disa karakteristika jo të favorshme:

- a. **Zhvillim jo të balancuar hapësinor** - Koncentrimi i zhvillimeve në zonën fushore, konkretisht hapësira në mes të shpateve perëndimore të Maleve të Karadakut dhe Malit Sharr. Në këtë zonë është e koncentruar pjesa dërmuese e popullsisë dhe vendbanimeve të komunës, veprimtaritë ekonomike, sociale, politike, nyjet kyçe të infrastrukturës dhe komunikimeve si dhe ekzistojnë konfliktet me zënien e tokës bujqësore që është e koncentruar po ashtu në këtë hapësirë. Toka bujqësore përshkohet nga dy lumenjtë më të mëdhenj të komunës së Kaçanikut, siç janë Lumi Lepenc dhe Nerodime.
- b. **Zhvillimet lineare** – Pothuaj se të gjitha zhvillimet janë të koncentruara përgjatë akseve kryesore rrugore: Vendbanimet, popullsia dhe tërë zhvillimi ekonomik.
- c. **Shfrytëzim jo racional i resurseve** - Fondi i tokës bujqësore është i pakët në komunën e Kaçanikut dhe si e tillë shtrihet kryesisht aty ku janë të koncentruara zhvillimet dhe ajo vazhdimisht po rrezikohet nga ndërtimet e pa planifikuara. Gjithashtu shfrytëzimi i gurit gëlqeror në disa pjesë të komunës është duke u shfrytëzuar në mënyrë jo racionale.


Me qëllim të realizimit të përshtatshëm të zhvillimeve hapësinore dhe menaxhimit të tyre, është bërë kombinimi i konceptit linear (ekzistues) dhe policentrik (shpërndarjes së administratës dhe disa shërbimeve) në komunën e Kaçanikut. Sipas këtij koncepti, komuna e Kaçanikut do të ketë zhvillim linear dhe policentrik me tendencë të vazhdueshme të zhvillimit të qëndrueshëm.

1.3. Zonat dhe aktivitetet e tyre

Komuna e Kaçanikut karakterizohet me dy struktura (tërësi) kryesore hapësinore, të cilat kanë dallime të theksuara në aspektin ekonomik, social, mjedisor, të infrastrukturës dhe shërbimeve.

1. **Zona aktive**
2. **Zona e vlerave natyrore**
 - a) Zona e vlerave natyrore – Lindore
 - b) Zona e vlerave natyrore – Perëndimore

Harta 43. Strukturat zhvillimit hapësinor



1. Zona aktive

Kjo zonë shtrihet kryesisht në pjesën veriore dhe veriperëndimore të komunës së Kaçanikut, në lartësi mbidetare deri në 700m. Përfshin pjesën fushore të komunës, ku janë të koncentruar gati të gjitha aktivitetet, vendbanimet, popullsia, shërbimet, infrastruktura etj, për çka edhe është quajtur zona aktive. Ka një sipërfaqe prej 8630 ha që përfshin 40,9 % të tërë territorit komunal. Në këtë zonë gjenden 21 komuna kadastrave, nga 29 sa ka gjithsej komuna e Kaçanikut, ku del se rreth 72 % e vendbanimeve gjenden në zonën aktive. Në këtë zonë jetojnë 34960 banor apo 91 % e popullsisë së gjithmbarshme të komunës.

Funksionet e kësaj zone janë:

Zhvillimi kompakt i vendbanimeve dhe ndalimi i ndërtimeve përgjatë akseve rrugore ruan dhe zhvillon tokën bujqësore. Me këtë zhvillim edhe investimet në bujqësi janë atraktive dhe afatgjata dhe si rrjedhim arrihet që bujku të ketë ndikimin e vet në politikat komunale të shfrytëzimit të tokës.

Zhvillimi modern i bujqësisë do të mundësoj kultivimin e kulturave bujqësore më profitabile duke zgjeruar sipërfaqet me kultura perimore si në fushë të hapur dhe serra, zgjerimin e sipërfaqeve me kultura pemëtare si dhe instalimin dhe zgjerimin e sistemit të ujitjes.

Zhvillimi i industrisë ushqimore do të jetë faktorë kyç i zhvillimit të bujqësisë në tërësi, bazuar në faktin që në njërin anë ekziston lidhje e mirë në rrjetin e infrastrukturës dhe transportit shetëror, afërsia me qendrat e mëdha urbane si dhe në anën tjetër do të ketë kërkesë për produkte ushqimore kualitative në këto qendra urbane.

Zhvillimi i tregtisë mbështetet në qasjen e mirë që ka komuna e Kaçanikut në rrjetin rrugorë dhe linjat e transportit shetëror, ku tregtia do të zhvillohet për nevoja lokale dhe regjionale.

Industria, lëndët e para që ofron komuna e Kaçanikut për industri janë kryesisht materiali ndërtimor, prodhimet bujqësore, blegtoral dhe minerare. Prandaj orientimi i industrisë në këto fusha do e ndihmoj shumë edhe bujqësinë në përgjithësi por edhe minierat sipërfaqësore (gurthyesit) të cilët më pastaj do të kenë ndikim më pak të dëmshëm mjedisorë.

Modernizimi dhe aktivizimi i plotë i ndërmarrjeve industriale është i rëndësishëm së lartë për shkak që do të zbut papunësinë dhe do të arrij që të tërheq edhe zhvillimin e sektorëve të tjerë të ekonomisë, duke përfshij edhe bujqësinë.

Gjithashtu edhe zhvillimi i industrisë ushqimore do të jetë faktorë kyç i zhvillimit të bujqësisë në tërësi bazuar në faktin që në njërin anë ekziston qasje e mirë në rrjetin e infrastrukturës dhe transportit shetëror si dhe afërsia me qendrat e mëdha urbane ndërsa në anën tjetër mund të krijohet lëndë e parë e mjaftueshme për përpunim si dhe kërkesa për produkte ushqimore cilësore në qendrat e tjera urbane (Ferizaj, Prishtinë, Gjilan, Prizren, etj).

Monitorimi i aktiviteteve të gurthyesve është çështje e cila duhet të merret në konsiderim në shumë dimensione edhe për faktin që disa gurthyes ose eskavatorë shkëmbi veprojnë ilegalisht në disa lokacione. Fillimisht do të kushtohet rëndësi të madhe mjedisit jetësorë pastaj edhe krijimit të mundësive për bizneset, në këtë rast edhe aktiviteteve të gurthyesve. Zonat të cilat deri tani janë eksploatuar duhet të nënshtrohen masave rehabilituese me qëllim të përmirësimit të mjedisit qoftë ai human apo natyrorë. Orientimi i shfrytëzimit të resurseve minerarë në industrinë ndërtimore do të ndihmoj që përfitimet të jenë më të mëdha por njëherit edhe shkalla e degradimit të mjedisit do të jetë më e vogël.

Turizmi i kësaj strukture është kryesisht i llojit kulturorë dhe peizazhorë i cili mund të zhvillohet kryesisht në kohëzgjatje njëditore. Janë disa hotele, restorante dhe motele që ofrojnë shërbime tradicionale dhe bashkëkohore për vizitorët të cilët kalojnë transit nëpër komunën e Kaçanikut por edhe për ata të cilët mund të vizitojnë ekskluzivisht

vizitojnë këtë komunë. Hoteleria, edhe motelet, restorantet dhe pishinat do të ofrojnë shërbime për nevojat e banorëve të komunës, por do të kenë ndikim në rritjen e mundësive për punësim dhe zhvillim ekonomik të komunës.

Prezenca e disa monumenteve kulturore (xhamia e Koxha Sinan Pashës, Spitali i mushkërive, disa kishat, hamame dhe tyrbe) kanë vlerën e vet në atraksionin turistikë të kësaj komune.

Peizazhi që ofron kjo zonë është mahnitës, për faktin që nga cilido vendbanim mund të shihen Malet e Sharrit por edhe Karadakut. Gjithashtu kombinimi i zonës së ndërtuar dhe me rripat e gjelbër natyrorë (kryesisht përgjatë rrjedhës së lumenjve dhe hapësirave të vogla me pyje) krijon një peizazh të veçantë dhe atraktiv i cili duhet të mbrohet dhe zhvillohet.

Transporti publik nuk është i kënaqshëm. Shtrirja e rrjetit të transportit në më shumë vendbanime, përmirësimi në rritjen e komoditetit në mjetet e transportit publik, respektimin rigoroz të itinerareve, janë problematika të cilat kërkojnë zgjidhje në vazhdim.

Zonat e biznesit do të jenë lokacione të cilat plotësojnë disa kritere bazë, duke filluar nga qasja në rrugët e karakterit shetëtror, plotësimi i nevojave të infrastrukturës tjetër teknike (rryme, ujë, kanalizim, telefoni, etj.), qasje e shpejt në qendrat e madha urbane, posedim të tokës në pronësi të komunës ose gatishmëri e komunitetit për ndërrim ose shitje të tokës në lokacione specifike, etj. Zonat të cilat i plotësojnë kriteret e lartpërmendura janë: hapësira rreth e përfaqë udhëkryqit në Doganaj, Kaçaniku, Kaçaniku i Vjetër dhe Stagova. Me përjashtim të Doganajt, këto lokacione kanë edhe stacione treni, gjë që i favorizon karshi zonave tjera potenciale në komunën e Kaçanikut.

2. Zona e vlerave natyrore

Pjesa më e madhe e territorit të komunës së Kaçanikut ka lartësi mbidetare mbi 700 m dhe përfshinë hapësirat e maleve të Sharrit dhe Karadakut. Tërë kjo hapësirë malore formon zonën e dytë që karakterizohet me vlera të rëndësishme natyrore dhe për këtë arsye është quajtur edhe zona e vlerave natyrore. Kjo zonë përfshinë rreth 12465 ha apo 59.1 % të territorit të komunës. Për shkak të veçorive fiziko-geografike, kjo zonë është e pasur me vlera natyrore të veçanta, por është më pak e banuar në krahasim me zonën aktive. Në tërë këtë hapësirë ekzistojnë vetëm 8 vendbanime dhe jetojnë rreth 3214 banorë apo vetëm 9 % e popullsisë së komunës.

Kjo zonë për shkak të specifikave qoi ka ndahet në dy nën zona

- a) Zona e vlerave natyrore – lindore
- b) Zona e vlerave natyrore – perëndimore

a) Zona e vlerave natyrore – lindore

Kjo zonë përfshin masivin malor të Karadakut, me një sipërfaqe rreth 4576 ha. Në këtë zonë gjenden vetëm 4 vendbanime me gjithsej 449 banor. Pra është një hapësirë që përbëhet kryesisht nga sipërfaqet pyjore, livadhet dhe kullosat. Masivi malor i Karadakut karakterizohet me vlera të larta natyrore, e sidomos zona e burimit të Moravës së Binçës që dallohet me bukuri natyrore.

Funksionet ekonomike të kësaj zone janë:

Pylltaria si aktivitet ekonomik kërkon trajtim jo vetëm si pasuri kombëtare por edhe si pasuri e komunës së Kaçanikut dhe do të zhvillohet në funksion të krijimit të ambientit të përshtatshëm jetësorë, turizmit dhe rekreacionit, duke mos penguar edhe zhvillimin e industrisë së drurit, mobileve dhe artizanaleve me kapacitet të kufizuar. Kapaciteti i kufizuar ka për qëllim mbrojtjen e pyjeve nga prerja e pakontrolluar për nevoja të përpunimit të tyre.

Blegtoria dhe zhvillimi intensiv i sajë do të jenë aktiviteti shumë të rëndësishme të kësaj zone, bazuar kryesisht në potencialin e kullosave dhe livadhe të cilat ka kjo zonë si dhe në vlerën ekologjike të tyre, e cila i bën specifike. Kullosat kapin një fond toke prej 4376,78 ha dhe janë potencial serioz në zhvillimin e blegtorisë në këtë zonë të cilat do të ndihmojnë kryesisht në zhvillimin ekonomik duke përfshirë të gjitha vendbanimet brenda zonës por edhe vendbanimet të cilat janë në kufi me këtë zonë.

Blegtoria do të zhvillohet kryesisht në vendbanimet si Gjurgjedell, Drenogllavë, Nikaj dhe Korbliq.

Bletaria ka në dispozicion të gjitha kushtet e favorshme për zhvillim në këtë zonë andaj edhe investimi në këtë degë të bujqësisë do të ndihmojë zhvillimit ekonomik dhe kulturorë të kësaj zone. Zhvillimi i bletarisë duhet stimuluar, si dhe duhet subvencionuar familjet të cilat dëshirojnë të merren me këtë veprimtari e cila është shumë profitabile, dhe si rrjedhojë, ka shumë mundësi të pengojë shpopullimin.

Turizmi malor dhe vikendor do të jenë llojet kryesore të turizmit në këtë zonë por fillimisht nevojitet infrastruktura adekuate, në mënyrë që potencialet turistike, kryesisht vlera natyrore turistike dhe peizazhet të shfrytëzohen.

Një ndër vlerat natyrore janë peizazhet e ndryshme të formuara nga kombinimi i pasurive pyjore, kullosave në kombinim me format gjemorfologjike të terrenit, si dhe në veçanti kataraktet e shumta në lumin e Kluqës

Zhvillimi i gjuetisë së kontrolluar do të jetë një tjetër ndihmues i vogël por i rëndësishme në zhvillimin e kësaj treve dhe regjimi kontrollues i gjuetisë i cili duhet të monitorohet rreptësisht.

Gurthyesit dhe eksploatimi sipërfaqësor i minerareve- duhet të bëhet licencimi i disa veprimtarive të cilat merren kryesisht me shfrytëzimin e shkëmbit ose të pezullohen aktivitetet e tyre. Fillimisht duhet të bëhet një vlerësim i gjendjes së tyre në aspektin mjedisore dhe socio-ekonomik e pastaj të merren vendime të caktuara të cilat do të bëjnë legalizimin ose ndalimin e aktiviteteve të tyre.

b) Zona e vlerave natyrore - perëndimore

Zona e vlerave natyrore perëndimore shtrihet në masivin malor të Sharrit dhe ka sipërfaqe prej 7889 ha. Në këtë zonë ekzistojë gjithsej 4 vendbanime me 2765 banorë, apo rreth 7 % e popullsisë së komunës. Në këtë zonë kryesisht shtrihen pyjet dhe kullosat si dhe fond i tokave bujqësore të kategorive III-VI-VII-VIII. Peizazhet natyrore në këtë zonë janë mjaft atraktive për rekreacion dhe turizëm. Mund të thuhet se pyjet dhe kullosat, si dhe guri gëlqeror janë resurset natyrore më të rëndësishme të zonës

perëndimore të komunës. Gjithashtu, në zonën e Masivit të Sharrit shtrihet zona e Mbrojtur e Parkut nacional „Mali Sharr”.

Funksionet e zonës:

Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik do të jetë qëllimi kryesor për këtë zonë. Parimet kryesore të zhvillimit janë shfrytëzimi i resurseve për nevoja momentale dhe ruajtja e tyre për nevojat e gjeneratave të ardhshme.

Zhvillimi i qëndrueshëm i bujqësisë krijon mundësi dhe kushte që veprimtaritë primare të zhvillohen kryesisht të mbështetura në leverdinë e tyre prodhuese dhe fitimprurëse, duke rritur sipërfaqet me kultura perimore në fushë të hapur dhe objekte të mbyllura-serra, zgjerimin e sipërfaqeve me kultura pemëtare, kafshë të mëdha dhe të imëta, bletari me identitet nga PNMSH, shfrytëzimin e ujërave sipërfaqësor dhe instalimin dhe zgjerimin e sistemit të ujitjes (sistemi i ujitjes pikë-pikë), krijon mundësi të favorshme për zhvillim.

Zhvillimi i blegtorisë në këtë zonë do të tejkalon mbajtjen e gjedheve për nevoja familjare dhe të konsumit të përditshëm të konsumit lokal siç është zhvilluar deri tani. Potencialet e shumta që ka kjo zonë, duke përfshirë fondin e madh të livadheve dhe kullosave, kushtet e përgjithshme ekologjike (drita, temperatura, ajri, lagështia, përbërja e tokës, flora dhe ekspozicioni), tradita dhe gatishmëria e banorëve të kësaj ane për ta zhvilluar këtë veprimtari primare, janë të gjitha këto resurse të pa kontestueshme për zhvillim të kësaj zone. Zhvillimi i kësaj veprimtaria primare do të mundësoj edhe zhvillimin ekonomik të vendbanimeve siç janë; Kotlina, Ivaja, Gajre, Gllaboçica, Strazha, Kovaçeci, Bobi, Biçeci dhe Sllatina, por njëkohësisht do të mundësoj edhe zhvillimin e industrisë në zonën aktive zhvillimore për shkak të posedimit të kushteve më të përshtatshme infrastrukture.

Bletaria ka në dispozicion të gjitha kushtet e nevojshme për zhvillim në këtë zonë andaj edhe investimi në këtë degë të bujqësisë do të ndihmoj zhvillimit ekonomik dhe kulturor të kësaj zone. Zhvillimi i bletarisë duhet stimuluar dhe subvencionuar familjet të cilat dëshirojnë të merren me këtë veprimtari e cila është shumë profitabile dhe si rrjedhojë edhe ka shumë mundësi të ngjall popullimin e kësaj zone dhe në veçanti të pengojë depopullimin e popullatës e cila aktualisht jetojnë në këtë zonë.

Pylltaria si aktivitet ekonomik kërkon trajtim jo vetëm si pasuri kombëtare por edhe si pasuri e komunës së Kaçanikut dhe do të zhvillohet në funksion të krijimit të ambientit të përshtatshëm jetësorë, turizmit dhe rekreacionit, duke mos penguar edhe zhvillimin e industrisë së drurit, mobileve dhe artizanaleve me kapacitet të kufizuar. Kapaciteti i kufizuar ka për qëllim mbrojtjen e pyjeve nga prerja e pakontrolluar për nevoja të përpunimit të tyre.

Turizmi është një veprimtari ekonomike e cila në këtë zonë ka të gjitha parakushtet e nevojshme për zhvillim, pasi që në këtë zonë shtrihet edhe Parku Nacional “Mali Sharr”, i cili i jep vlerë të veçantë kësaj zone. Resurset e shumta që ka kjo zonë përfshijnë peizazhin, pyjet, burimet ujore dhe ujërat rrjedhëse, format e ndryshme relievo dhe shpatet e përshtatshme për skijim. Resurset turistike përcaktojnë edhe llojet kryesore të turizmit në këtë zonë por fillimisht nevojitet të instalohet infrastrukturë e nevojshme në

mënyrë që potencialet turistike të shfrytëzohen. Turizmi nuk mund të zhvillohet si sektorë i veçantë por duhet dhe do të zhvillohet në kombinim më të gjitha sektorët ekonomik, social, infrastrukturorë dhe mjedisorë.

Theks të veçantë duhet kushtuar edhe ndërtimit të qendrës shijimit në Lybeten por paraprakisht duhet të bëhet një planë rregullues infrastrukturorë pastaj të implementohet aj planë në tersi dhe pasi të jetë realizuar kjo vepër e ardhshme kapitale atëherë edhe leverdia ekonomike në këtë zonë do të shihet konkretisht.

Gjithashtu edhe turizmi transit ka të gjitha paradispozitat të zhvillohet jo vetëm në këtë zonë por edhe për gjithë komunën e Kaçanikut.

Potenciali hidroenergjetike do të mundësojë jo vetëm furnizim të qëndrueshëm më ujë të pijes për shumë fshatra, zgjerimin e sipërfaqeve nën ujitje duke ndihmuar bujqësinë në zhvillimin e të gjitha degëve të sajë të mundshme për tu zhvilluar si dhe shfrytëzimin e këtij resursi për prodhimin e energjisë elektrike.

Potenciali hidroenergjetik i kësaj zone është shumë i madh për shkak se kemi disa rrjedhe ujore, ndër këto rrjedhe ujore më të rëndësishme janë dy prej tyre (Kotlinë dhe Dubravë), ku edhe mund të shfrytëzohet uji, përveç tjerash edhe për prodhimin e energjisë elektrike.

Mundësia e shfrytëzimit të **energjisë erës** është gjithashtu potencial shumë i mundshëm, por paraprakisht duhet përgatitet një studim i hollësishëm i cili do të tregojë në detaje mundësit e shfrytëzimit të energjisë së erës në komunën e Kaçanikut.

1.4. Qendrat dhe organizimi funksional i komunës

Që të arrihet një organizim më efikas i shërbimeve, planifikohet të realizohet një zhvillim i ri i qendrave dhe organizimi funksional i tyre. Riorganizimi bazohet në gjendjen ekzistuese dhe në zhvillimet aktuale, ku do të krijohen edhe qendra tjera me rendësi për një funksionalitet më të mirë.

Përmes zhvillimit të këtyre qendrave mundësohet shpërndarja e funksioneve dhe shërbimeve në territorin e komunës. Një sistem i tillë hierarkik u mundëson banorëve të komunës të kenë qasje më të lehtë në shërbime. Arritshmëria është një nga komponentët e rëndësishme të planifikimit që ndikon në përmirësimin e standardit jetësor të banorëve.

Plani Zhvillimor propozon sistemin hierarkik të vendbanimeve në tri kategori, duke mos humbë rëndësia e qendrës komunale të Kaçanikut.

Plani Zhvillimor Komunal e sugjeron një sistem hierarkik me tri nivele:

- ✓ Qendra komunale
- ✓ Qendrat sekondare
- ✓ Qendrat lokale

Qendra komunale është e vendosur në qytetin e Kaçanikut. Qyteti do të zhvillohet sipas objektivave në vijim:

- ✓ Zhvillim të industrisë dhe tregtisë,
- ✓ Zhvillim të tregtisë me shumicë e pakicë, që ofrojnë produkte të karakterit afatgjatë e afatshkurtër,



01Nr. 104/02-38073/21
Kačanik, 29.12.2021

Në bazë të nenit 13 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.06/L-092 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin të Pronës së Paluajtshme të Komunës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr.10/03 Prill 2019), neni 6 par.1 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 Për përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, dhe neni 6 shkronja h) të Statutit të Komunës së Kaçanikut, duke vendosur sipas Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës 01Nr. 104/02-38073/21 prej datës 20.12.2021, Kuvendi i Komunës Kačanik në mbledhjen e mbajtur me 29 dhjetor 2021, mori këtë:

VENDIM

PËR APROVIMIN E LISTËS SË VEÇANTË TË PRONAVE KOMUNALE TË CILAT PLANIFIKOHEN TË JEPEN NË SHFRYTËZIM NË VITIN 2022

1. Me këtë Vendim, Aprovohet Lista e Veçantë e pronave komunale të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim në vitin 2022, si vijon:

Zona kadastrale Bajnicë:

1. Parcela kadastrale, nr.00378-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.20.62 ha
2. Parcela kadastrale, nr. 00388-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.68.70 ha
3. Parcela kadastrale, nr.00389-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.41.75 ha
4. Parcela kadastrale, nr.00536-1, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.86.51 ha
5. Parcela kadastrale, nr.00536-2, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.38.31 ha

Zona kadastrale Begracë:

1. Parcela kadastrale, nr.01853-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.77.92 ha
2. Parcela kadastrale, nr. 02240-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.79.48 ha
3. Parcela kadastrale, nr.02578-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.66.12 ha
4. Parcela kadastrale, nr.02579-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 02.16.79 ha
5. Parcela kadastrale, nr.02639-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 05.72.58 ha
6. Parcela kadastrale, nr. 02706-1, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.61.44 ha
7. Parcela kadastrale, nr.02706-3, në sipërfaqe të tërësishme prej 02.09.05 ha
8. Parcela kadastrale, nr.02706-4, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.11.39 ha
9. Parcela kadastrale, nr.02706-5, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.61.42 ha
10. Parcela kadastrale, nr.02647-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.26.74 ha

Zona kadastrale Bob:

1. Parcela kadastrale, nr.00247-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.40.14 ha

Zona kadastrale Biqec:

1. Parcela kadastrale, nr.00032-1, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.10.43 ha
2. Parcela kadastrale, nr. 00032-2, në sipërfaqe të tërësishme prej 01.45.99 ha
3. Parcela kadastrale, nr.01006-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 01.53.47 ha
4. Parcela kadastrale, nr.01068-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.91.14 ha
5. Parcela kadastrale, nr.01439-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 09.13.97 ha
6. Parcela kadastrale, nr. 01440-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.51.80 ha
7. Parcela kadastrale, nr.01470-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 01.91.98 ha
8. Parcela kadastrale, nr.01478-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.94.16 ha
9. Parcela kadastrale, nr.01479-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 01.36.63 ha

Zona kadastrale Vatë - Dubravë:

1. Parcela kadastrale, nr.00150-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 01.56.05 ha
2. Parcela kadastrale, nr. 00473-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.91.36 ha
3. Parcela kadastrale, nr.00474-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.13.85 ha
4. Parcela kadastrale, nr.00545-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 02.05.89 ha
5. Parcela kadastrale, nr.00546-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 01.17.73 ha
6. Parcela kadastrale, nr. 00547-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 01.95.10 ha
7. Parcela kadastrale, nr.00719-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 02.03.94 ha
8. Parcela kadastrale, nr.00734-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 03.93.62 ha
9. Parcela kadastrale, nr.01127-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 02.57.76 ha
10. Parcela kadastrale, nr.01137-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.86.06 ha
11. Parcela kadastrale, nr.01162-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.91.82 ha

Zona kadastrale Gajre:

2. Parcela kadastrale, nr.00098-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.51.02 ha

Zona kadastrale Gilboçicë:

1. Parcela kadastrale, nr.01736-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.57.10 ha
2. Parcela kadastrale, nr. 01782-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.22.24 ha
3. Parcela kadastrale, nr.01790-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.71.14 ha
4. Parcela kadastrale, nr.01795-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.72.61 ha
5. Parcela kadastrale, nr.01796-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.33.82 ha
6. Parcela kadastrale, nr. 01797-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.10.00 ha
7. Parcela kadastrale, nr.01802-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 01.22.35 ha

Zona kadastrale Doganaj:

1. Parcela kadastrale, nr.00143-1, në sipërfaqe të tërësishme prej 01.87.77 ha
2. Parcela kadastrale, nr. 00143-2, në sipërfaqe të tërësishme prej 01.50.01 ha
3. Parcela kadastrale, nr.00143-3, në sipërfaqe të tërësishme prej 01.49.95 ha
4. Parcela kadastrale, nr.00145-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.42.56 ha
5. Parcela kadastrale, nr.00225-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.30.51 ha
6. Parcela kadastrale, nr. 00227-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.16.92 ha

Zona kadastrale Duraj - Gabriçë:

1. Parcela kadastrale, nr.00119-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 01.09.15 ha
2. Parcela kadastrale, nr. 00121-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.54.38 ha

3. Parcela kadastrale, nr.00293-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 03.49.00 ha
4. Parcela kadastrale, nr.00430-1, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.45.06 ha

Zona kadastrale Gjurgjedell:

1. Parcela kadastrale, nr.00308-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.23.94 ha
2. Parcela kadastrale, nr. 00309-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 01.19.72 ha
3. Parcela kadastrale, nr.00536-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 03.58.37 ha
4. Parcela kadastrale, nr.00643-1, në sipërfaqe të tërësishme prej 02.84.29 ha
5. Parcela kadastrale, nr.00655-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 14.35.41 ha

Zona kadastrale Flezaj:

1. Parcela kadastrale, nr.00137-1, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.51.72 ha
2. Parcela kadastrale, nr. 00137-2, në sipërfaqe të tërësishme prej 01.00.66 ha
3. Parcela kadastrale, nr.00139-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.30.73 ha

Zona kadastrale Ivaçë:

1. Parcela kadastrale, nr.00186-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 01.84.75 ha
2. Parcela kadastrale, nr. 00281-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.71.55 ha
3. Parcela kadastrale, nr.00299-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 01.26.74 ha
4. Parcela kadastrale, nr.00300-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.78.76 ha
5. Parcela kadastrale, nr.00422-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.70.51 ha
6. Parcela kadastrale, nr. 00423-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.75.00 ha

Zona kadastrale Kaçanik:

1. Parcela kadastrale, nr.00005-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 01.26.38 ha
2. Parcela kadastrale, nr. 00072-1, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.37.83 ha
3. Parcela kadastrale, nr.00568-2, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.76.68 ha
4. Parcela kadastrale, nr.00568-3, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.23.97 ha
5. Parcela kadastrale, nr.00682-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.42.59 ha
6. Parcela kadastrale, nr.00888-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.45.31 ha
7. Parcela kadastrale, nr.00889-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.88.63 ha
8. Parcela kadastrale, nr.00890-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 02.09.99 ha
9. Parcela kadastrale, nr. 00891-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.51.89 ha
10. Parcela kadastrale, nr. 01866-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.68.68 ha

Zona kadastrale Kaçanik i Vjetër:

1. Parcela kadastrale, nr.00401-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 03.45.94 ha
2. Parcela kadastrale, nr. 00418-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.90.01 ha
3. Parcela kadastrale, nr.00419-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.29.50 ha
4. Parcela kadastrale, nr.00421-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.65.51 ha
5. Parcela kadastrale, nr.00576-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 02.89.90 ha
6. Parcela kadastrale, nr. 00728-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.46.84 ha

Zona kadastrale Kovaçec:

1. Parcela kadastrale, nr.00101-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.91.76 ha
2. Parcela kadastrale, nr. 00234-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 03.11.51 ha
3. Parcela kadastrale, nr.00269-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 03.46.16 ha
4. Parcela kadastrale, nr.00283-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 01.71.08 ha

5. Parcela kadastrale, nr.00063-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.43.83 ha

Zona kadastrale Kotlinë:

1. Parcela kadastrale, nr.00068-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.19.60 ha
2. Parcela kadastrale, nr. 00069-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 05.72.39 ha
3. Parcela kadastrale, nr. 00120-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.65.03 ha
4. Parcela kadastrale, nr.00132-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 01.52.25 ha
5. Parcela kadastrale, nr.00154-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 01.87.96 ha
6. Parcela kadastrale, nr.00232-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 02.01.36 ha
7. Parcela kadastrale, nr. 00298-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 01.12.62 ha
8. Parcela kadastrale, nr.00511-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 03.63.41 ha
9. Parcela kadastrale, nr.00512-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 02.60.26 ha
10. Parcela kadastrale, nr.00608-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 08.49.77 ha
11. Parcela kadastrale, nr.00737-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 05.88.18 ha
12. Parcela kadastrale, nr.00799-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 03.54.39 ha
13. Parcela kadastrale, nr.00850-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 77.69.76 ha
14. Parcela kadastrale, nr.00851-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 01.17.97 ha
15. Parcela kadastrale, nr.00976-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 09.99.22 ha
16. Parcela kadastrale, nr.01069-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 01.17.99 ha
17. Parcela kadastrale, nr.01108-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 03.02.86 ha

Zona kadastrale Koxhaj:

1. Parcela kadastrale, nr.00156-1, në sipërfaqe të tërësishme prej 01.63.08 ha
2. Parcela kadastrale, nr. 00156-2, në sipërfaqe të tërësishme prej 01.49.74 ha
3. Parcela kadastrale, nr.00391-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.62.69 ha
4. Parcela kadastrale, nr.00546-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.27.76 ha

Zona kadastrale Nikaj:

1. Parcela kadastrale, nr.00298-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.18.98 ha
2. Parcela kadastrale, nr. 00299-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.29.97 ha
3. Parcela kadastrale, nr.00626-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 02.34.31 ha
4. Parcela kadastrale, nr.00632-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.33.08 ha
5. Parcela kadastrale, nr.00633-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 04.74.60 ha
6. Parcela kadastrale, nr.00634-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 05.78.97 ha
7. Parcela kadastrale, nr. 00790-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.23.82 ha
8. Parcela kadastrale, nr.00791-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.39.84 ha

Zona kadastrale Rekë:

1. Parcela kadastrale, nr.00085-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.49.26 ha
2. Parcela kadastrale, nr. 00087-1, në sipërfaqe të tërësishme prej 01.80.54 ha
3. Parcela kadastrale, nr.00102-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.30.00 ha
4. Parcela kadastrale, nr.00121-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.69.05 ha
5. Parcela kadastrale, nr.00156-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.56.60 ha
6. Parcela kadastrale, nr. 00382-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 01.61.23 ha
7. Parcela kadastrale, nr.00385-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 01.41.25 ha
8. Parcela kadastrale, nr.00737-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 01.67.51 ha
9. Parcela kadastrale, nr.00740-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 12.08.44 ha

Zona kadastrale Runjevë:

1. Parcela kadastrale, nr.00010-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 01.07.92 ha
2. Parcela kadastrale, nr. 00098-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.22.17 ha
3. Parcela kadastrale, nr.00099-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 00.62.55 ha
4. Parcela kadastrale, nr.00135-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 01.80.23 ha
5. Parcela kadastrale, nr.00137-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 06.82.00 ha
6. Parcela kadastrale, nr. 00139-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 03.91.23 ha
7. Parcela kadastrale, nr.00227-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 01.10.60 ha
8. Parcela kadastrale, nr.00481-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 02.81.54 ha

Zona kadastrale Sllatinë:

1. Parcela kadastrale, nr.00202-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 01.56.42 ha
2. Parcela kadastrale, nr. 00203-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 01.37.12 ha
3. Parcela kadastrale, nr.00210-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 01.18.66 ha

Zona kadastrale Stagovë:

1. Parcela kadastrale, nr.00204-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 02.75.79 ha
2. Parcela kadastrale, nr. 00205-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 01.16.02 ha
3. Parcela kadastrale, nr.00206-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 01.92.03 ha
4. Parcela kadastrale, nr.00298-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 04.04.46 ha
5. Parcela kadastrale, nr.00377-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 04.12.16 ha
6. Parcela kadastrale, nr.00730-0, në sipërfaqe të tërësishme prej 24.56.59 ha

2. Lista e veçantë e pronave komunale të cilat do të jepen në shfrytëzim në vitin 2022 të përcaktuara si në këtë vendim, do të bëhet publike në Faqen Zyrtare të Komunës.

3. Për zbatimin e këtij Vendimi do Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit.

4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës të MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Faqen Zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen: MAPL, Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit dhe Arkivi.





01.Nr.104/02-20245/22
Kačanik, 28.07.2022

Në mbështetje të nenit 5, 6 pika 1.2, 14.3 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 10 / 03 prill 2019), të nenit 4, 5 pika 1.3 të Rregullores (QRK) – Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, të nenin 6 (h) të Statutit të Komunës së Kaçanikut, të Vendimit të KK 01Nr. 104/02-38073/21 të datës 29.12.2021, Kuvendi i Komunës Kačanik në mbledhjen e mbajtur me 28 Korrik 2022, mori këtë:

**VENDIM PARAPRAK
PËR DHËNIEN E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS
NË SHFRYTËZIM AFATGJATË**

1. Me këtë Vendim fillon procedura nga komisioni vlerësues për Dhënien në Shfrytëzim AFATGJATË, për pronat e paluajtshme të Komunës së Kaçanikut, personave fizik dhe juridik.

2. Pronat e paluajtshme për dhënie në shfrytëzim të cekura si në pikën 1. të këtij Vendimi, për dhënie në shfrytëzim në periudhë afatgjatë kohore janë:

2.1 Njësia Kadastrale me nr.00293-0, me kulturë kullosë e klasës 3, me sipërfaqe prej 03.49.00 ha, zona kadastrale Duraj.

2.2 Njësia Kadastrale me nr.01866-0, me kulturë livadh i klasës 5, me sipërfaqe prej 00.68.68 ha, zona kadastrale Kačanik.

2.3 Njësia Kadastrale me nr.00232-0, me kulturë kullosë e klasës 4, me sipërfaqe prej 02.01.36 ha, zona kadastrale Kollinë.

2.4 Njësia Kadastrale me nr.00156-2, me kulturë kullosë e klasës 4, me sipërfaqe prej 01.49.74 ha, zona kadastrale Koxhaj, jepet në shfrytëzim sipërfaqja prej 1,00.00 ha (1 hektarë).

3. Pronat e përcaktuara në njësitë kadastrale të pikave; 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4 të këtij Vendimi, janë prona të Komunës së Kaçanikut.

4. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës komunale është; krijimi i kushteve për zhvillim të bizneseve, krijimi i mundësisë për investime nga investitorë vendor dhe të huaj, me ç' rast do të krijohen vende të reja të punës, të lartcekura janë pjesë e listës së veçantë të pronave komunale me Vendimin 01Nr. 104/02-38073/21 të datës 29.12.2021 nga Kuvendi i Komunës së Kaçanikut të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim në vitin 2022.

5. Procedurat e parapara me Ligjin Nr. 06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe me Rregullores (QRK) – Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës do t'i zhvilloj. Komisioni Vlerësues për dhënie në shfrytëzim pronën e paluajtshme të komunës, i formuar me Vendim të Kuvendit të Komunës.

6. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës.

7. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyren e protokollit të autoritetit mbikëqyrës – MAPI-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në Faqen zyrtare të komunës.

Vendimi iu dërgohet: MAPI, Komisionit, Kryetari të Komunës, DUKMM, DZHET, Arkiv it.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli




Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration



Për :	Besim Ilazi, Kryetar i Komunës së Kaçanikut Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Venera Çerkini, Zv. Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga:	Besim Myrtezani, Zv. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Data: 12.03.2022 VI-020-573
Zyrtarët përgjegjës:		
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave	
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Gëzim Sahiti, Zyrtarë për Monitorimin e Komunave	
Lënda:	Shqyrtim i ligjshmërisë e aktit të Kuvendit të Komunës	
Lloji i aktit:	Vendim 01 Nr.104/02-20245/22 i datës 28.07.2022 i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut	

I/e nderuar Kryetar,
I/e nderuar Kryesues,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në mbështetje të nenit 81.4 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshim-plotësimin e Rregullores (QRK)nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, MAPL, me datë 01.08.2022 ka pranuar për vlerësim të ligjshmërisë Vendimin 01 Nr.104/02-20245/22, vendim paraprak për dhënien e pronës së pajtshme në shfrytëzim afatgjatë, të nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Kaçanikut.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), ka bërë shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe:

KONFIRMON

Vendimin 01 Nr.104/02-20245/22, vendim paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim afatgjatë, është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Kaçanikut në mbledhjen e mbajtur me datë 28.07.2022, ka miratuar Vendimin 01 Nr.104/02-20245/22, vendim paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim afatgjatë.

MAPL, konstator së vendimi i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Kaçanikut është bazuar në nenin 12 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 5, nenin 6 pika 1.2, neni 14 pika 1.3 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenin 4, nenin 5 pika 1.3 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës. Vendimin 01 Nr.104/02-20245/22, vendim paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim afatgjatë është miratuar në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Kaçanikut me datë 28.07.2022, me 14 vota për, 7 kundër dhe 5 abstenime.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.